



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



## Terma Reference

### Thirrje për ekspert për zhvillimin e modulit për menaxhimin e rasteve për fëmijët në familjet e radikalizuara

<b>Konsulenca</b>	Ekspert për zhvillimin e modulit për menaxhimin e rasteve për fëmijët në familjet e radikalizuara
<b>Projekti</b>	Riintegrimi i individëve dhe komuniteteve në rrezik të radikalizimit duke u mundësuar atyre të ridrejtojnë jetën e tyre dhe të bëhen anëtarë kontribues të komuniteteve të tyre
<b>Kohëzgjatja e shërbimit</b>	Janar - Mars 2024
<b>Lloji i kontratës</b>	Kontratë Shërbimi
<b>Data e fillimit të punës</b>	20 Janar 2024

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë një **Ekspert për zhvillimin e modulit për menaxhimin e rasteve për fëmijët në familjet e radikalizuara** në kuadër të projektit “ Riintegrimi i individëve dhe komuniteteve në rrezik të radikalizimit duke u mundësuar atyre të ridrejtojnë jetën e tyre dhe të bëhen anëtarë kontribues të komuniteteve të tyre” zbatuar në partneritet me Ambasadën Amerikane në Tiranë.

#### Informacion i Përgjithshëm:

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimisht NISMA) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupe më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbimit ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

#### Përshkrim i projektit:

Projekti ofron një qasje holistike për parandalimin, identifikimin dhe riintegrimin e individëve në rrezik për t'u radikalizuar. Projekti synon profesionistët në nivel lokal që kanë përgjegjësinë për t'u marrë me ekstremizmin e dhunshëm dhe rastet e individëve dhe komuniteteve në rrezik për t'u radikalizuar.

#### Përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit janë:

- Profesionistët e vijës së parë, punonjës të NJMF/GTN-ve të përfshirë drejtpërdrejt në menaxhimin



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



e rasteve të fëmijëve në rrezik për t'u radikalizuar ose vuajtur nga pasojat e familjeve të radikalizuara,

- fëmijët dhe familjet e tyre përfitojnë nga mbështetja e drejtpërdrejtë nga shërbimet direkte,
- institucionet shtetërore që zbatojnë procesin e menaxhimit të rasteve të fëmijëve që i përkasin familjeve të radikalizuara.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë për ekspertin:**

Eksperti ka si detyrë të hartojë një modul praktik të menaxhimit të rasteve të fëmijëve/familjeve të identifikuara si të radikalizuara apo të përfshirë në ekstremizmin e dhunshëm apo në rrezik të lartë.

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

1. Njohja e mekanizmit aktual të menaxhimit të rasteve:
  - legjislacioni dhe politikat përkatëse në nivel lokal dhe qendror;
  - procedura dhe protokolle të shkruara të përdorura nga profesionistët për menaxhimin e rasteve të fëmijëve dhe familjeve në nevojë, duke përfshirë rastet e fëmijëve dhe familjeve të radikalizuara apo të përfshirë në ekstremizmin e dhunshëm;
  - rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse.
2. Njohja me shenjat e radikalizimit dhe përfshirjes së ekstremizmit të dhunshëm në komunitet:
  - Rrjetet ekzistuese që kanë rol në identifikimin e shenjave të radikalizimit
  -
3. Propozimin e një pakete me mjete praktike për procesin e menaxhimit të rastit që përfshin të gjitha dimensionet e tij sikurse janë parashikuar në Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve":
  - Ngritja e dosjeve elektronike dhe (hard copy) i rasteve të menaxhuara;
  - Hartëzimin e shërbimeve ofruesve në nivel lokal për menaxhimin e rastit;
  - Funkcionimi i bashkëpunimit ndërsektorial;
  - Përfshirja në grupet teknike ndërsektoriale dhe roli i cdo anëtari në hartimin e planit të mbrojtjes së fëmijëve për çdo rast të menaxhuar duke konsideruar dhe sektorët që lidhen me sigurinë;
  - Njohja me të gjitha fazat e menaxhimit të rastit, (Identifikim/ Referim; vlerësimi fillestar; vlerësimi i plotë; Planifikimi i Mbrojtjes dhe Përkujdesit; zbatimi, monitorimi dhe ndjekja e planit; mbyllja e rastit;
  - Supervizimin profesional.

### **Eksperti do të dorëzojë:**

- Planin e punës për zhvillimin e modulit;
- Metodologjinë për hartimin e instrumenteve dhe mjeteve mbështetëse (realizimin e takimeve, intervistave dhe fokus grupeve për njohjen me praktikën e zbatuar deri tani);

### **Profili i ekspertit:**

#### **Kualifikime dhe eksperiencë**



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



- Diplomë universitare ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e shkencave sociale, kryesisht në punë sociale;
- Njohuri shumë të mira rreth situatës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
- Të jëtë njohës shumë i mirë i fenomenit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri.
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore për fëmijët dhe shërbimet në mbrojtje të tyre në Shqipëri; njohje të Ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe VKM-ve shoqëruese”; njohje të Ligji 121/2016 “Shërbime të kujdesit shoqëror”;
- Më tepër se 5 vite eksperiencë profesionale si ekspert, dhe praktike në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve në situatë vulnerabël;
- Trajnime dhe eksperiencë të mëparshme në vlerësimin e nevojave të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve;
- Përvojë me koordinimin e veprimeve për realizimin e raporteve dhe analizave në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.
- Njohuri shumë të mira në gjuhën angleze;
- Aftësi shumë të mira në shkrim, prezantim dhe analizë;
- Aftësi të mira në përgatitje dhe implementim të metodologjisë së vlerësimit të nevojave;
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi shumë të mira në komunikim, dhe zgjidhje konfliktesh;
- Aftësi për të punuar në presion kohe dhe në mënyrë të pavarur

**Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve:** Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes të NISMA ARSIS.

**Koha e mundshme e fillimit të punës është 20 Janar 2024.**

**Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës Janar - Mars 2024.**

Kjo ekspertizë përfshin 15 ditë pune në total.

#### **Procedura e Aplikimit:**

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për secilin nga pozicionet e sipër shënuara duhet të dërgojnë me email

- 1- CV-në;
- 2- Letër interesi;
- 3- Letër angazhimi/disponueshmërie;
- 4- Ofertën financiare;
- 5- Taksa e regjistrimit (nëse disponohet).

në adresën e emailit: [initiative.arsis@gmail.com](mailto:initiative.arsis@gmail.com) deri në datën **17 Janar 2024**, mesnatë ose pranë zyrave të NISMA në adresën Rruga “Sali Butka”, Pallati T.B.M, Shkalla 2, Apartamenti 1, Kati 1, Nj. Administrative nr. 7, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri .

***Në vemendjen tuaj që në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: Aplikim për pozicionin e ekspert për hartimin e modulit.***

#### **Procedura e Vlerësimit:**



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



Qendra e Koordinimit  
KUNDËR EKSTREMIZMIT  
TË DHUNSHËM  
- Shqipëri



Zgjedhja e ekspertit/grupit të ekspertëve do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Vlerat në %</b>
Kualifikime	30%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	20%

***Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.***